



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 qershor 2015
Nr. ref.: VHPK 804/15

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

në

Rastin nr. K103/15

Parashtrues

Hasan Beqiri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme,
API-KZI nr. 2/2011, të 25 majit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Hasan Beqiri, i cili ndodhet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, API-KZI nr. 2/2011, të 25 majit 2012 që, sipas informacioneve të parashtruesit, atij i është dorëzuar më 22 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të parashtruesit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 19 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti kompletimin e kërkesës me dokumentacion relevant.
8. Më 13 maj 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës është akuzuar për një vepër penale, është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim. Parashtruesi është duke e vuajtur dënimin në burgun e Dubravës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

10. Parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare, pa specifikuar ndonjë dispozitë kushtetuese konkrete.
11. Parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta nuk administrojnë në mënyrën e duhur provat dhe faktet e rastit, për çfarë edhe cilësimi i veprës penale ka qenë i gabuar.

12. Për më tepër, parashtruesi kërkon që shkelja e pretenduar e të drejtave të njeriut të vlerësohen nga Gjykata, duke u bazuar në pretendimet e tij të ngritura në kërkesë.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.
14. Kësisoj, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i Kërkesave]

“4. Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të... plotësuar kërkesën (...).”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...).”

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që përcakton:

29 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...].”

32 (5) “Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën (...).”

16. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare, pasi që faktet dhe provat nuk ishin paraqitur në mënyrën e duhur, ku për pasojë kualifikimi i veprës penale ishte i gabuar.
17. Gjykata, bazuar në nenin 22. 4 të Ligjit, kërkoi nga parashtruesi që të dorëzonte vendimin e kontestuar dhe vendimet tjera të gjykatave të rregullta.
18. Megjithatë, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta.
19. Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit, pa dokumente dhe prova materiale mbështetëse, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

20. Gjykata më tej konsideron se, parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e të gjitha kriterëve procedurale të pranueshmërisë.
21. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e përgjegjësisë, bie mbi parashtruesin e kërkesës që nuk ka arritur të përmbushë kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të kërkesës me dokumentacion relevant, ashtu siç kërkohet me nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.
23. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa me procedurë të shkurtër hedhet poshtë dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 22. 4 dhe 48 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullat 29 (2) (h), 32 (5) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani